



РЕПУБЛИКА СЕВЕРНА МАКЕДОНИЈА  
REPUBLIKA E MAQEDONISË SË VERIUT

Бр./Nr \_\_\_\_\_

\_\_\_\_\_г./в.



Në bazë të nenit 22 paragrafi 1 të Ligjit për parandalimin e korrupsionit dhe konfliktit të interesave ("Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 12/19), neni 40 paragrafi 2 i Rregullores së punës së Komisionit Shtetëror për Parandalimin e Korrupsioni, duke vepruar në rastin e formuar pas kërkesës së paraqitur nga parashtruesi i njohur, Komisioni Shtetëror për Parandalimin e Korrupsionit (në tekstin e mëtejme KSHPK), në seancën e 81-të të mbajtur më 18.01.2023 ka miratuar si në vijim.

### Vendim

Denoncimi i regjistruar me numër 12-627/1 të datës 09.02.2021, me pretendime për kufuzimin e konkurrencës gjat zbatimit të procedurave për prokurime publike, HIDHET POSHTË .

KSHPK-ja konstatoi se sipas Ligjit për Parandalimin e Korrupsionit dhe Konfliktit të Interesit nuk ka kompetencë për veprim për rastin e lëndës, dhe lënda do t'i dërgohet për veprim kompetent organit tjetër.

Lënda me numër 12-627/1 të datës 09.02.2021 të mbyllet dhe të arkivohet .

Vendimi i KSHPK-së, në formë të depersonalizuar, të publikohet në ueb - faqen e KSHPK-së brenda 5 (pesë) ditëve nga dita e vendimmarrjes.

### Arsyetim

Nga një parashtrues i panjohur më 09.02.2021 është dorëzuar denoncim me pretendime për kufizim të konkurrencës gjat zbatimit të procedurës për prokurime publike dhe u formua lënda me numër 12-627/1 të datës 09.02.2021.

Në denoncim parashtruesi thekson se procedurat për prokurime publike zbatohen në përputhje me Ligjin për prokurime publike, por me specifika teknike abstrakte që favorizojnë.

Autoritetet kontraktore, pas shfuqizimit të Këshillit të Prokurimit Publik, fabrikuan specifikime teknike, më së shumti në procedurat e prokurimit të letrave të zyrës, me kushte që i përshtateshin vetëm një kompanie të favorizuar. Operatorët ekonomik kanë shfrytëzuar mundësitë dhe mjetet ligjore, përkatësisht kanë paraqitur ankesa tek \_\_\_\_\_, ndërsa ankesat e pranuar nuk janë zbatuar në praktikë.

Favorizimi i operatorëve të caktuar ekonomik është realizuar në atë mënyrë që në specifikacionin teknik janë futur produkte të cilat nuk u duheshin autoriteteve kontraktore dhe ata kanë njoftuar paraprakisht kompanitë e tyre të afërta, duke u dhënë atyre përparësi në procedurë, ndërsa gjatë dorëzimit dhe pranimit nga mallrat që janë objekt i kontratës së prokurimit publik janë shënuar sasi që nuk korrespondojnë me sasinë e dorëzuara realisht. Sa më sipër ishte rasti në procedurat për prokurimin publik të \_\_\_\_\_ me numrin e njoftimit: \_\_\_\_\_/\_\_\_\_\_ - dhe \_\_\_\_\_

\_\_\_\_\_ procedura për prokurimin publik të \_\_\_\_\_  
nevojat e \_\_\_\_\_, \_\_\_\_\_ me numër shpalljeje:  
\_\_\_\_\_/\_\_\_\_\_.

Pas shqyrtimit të rastit të lëndës, KSHPK-ja konstatoi se në rastin bëhet fjalë për pretendime të cilat nuk i nënshtrohen veprimit kompetent të sajë, por bëhet fjalë për pretendime të lidhur me veprim kompetent të një organi tjetër, në rastin konkret Komisioni për mbrojtjen e konkurrencës e cila është kompetente për të kontrolluar zbatimin e dispozitave dhe rregulloreve të miratuara në bazë të Ligjit për Mbrojtjen e Konkurrencës, të cilat rregullojnë format e ndaluara të parandalimit, kufizimit apo shtrembërimit të konkurrencës, si dhe masat dhe procedurat që lidhen me kufizimet e konkurrencës.

Nga këtu KSHPK-ja vlerësoi se nuk ka kompetencë për veprim në rastin në fjalë, ndërsa denoncimin do ta dërgojnë për veprim kompetent organit tjetër.

Në bazë të së theksuarës, KSHPK-ja vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi

Përgatiti: B.M.

Miratoi: G.T., anëtarë i KSHPK-së

**KOMISIONI SHTETËRORE PËR  
PARANDALIMIN E KORRUPTIONIT  
KRYETARE,  
Biljana Ivanovska**